

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës  
Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Moduli 2 - Lënda për  
Ekspert të licensuar të  
Forenzikës Financiare**

**M2**

Nr

**Udhëzime/Instructions:**

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT  
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE  
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË  
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË  
TË KËTIJ PROVIMI.  
Your name should appear nowhere in this test.

Data 08.01.2020

1. Artani, një Examinues i Certifikuar i Mashtrimeve, sapo ka filluar një intervistë me Drenin. Pas prezantimit të tij dhe vendosjes së raportit me Drenin, çfarë duhet të bëjë Artani më pas?
  - A. Përcaktimi i temës së intervistës**
  - B. Filloni të bëni pyetje
  - C. Vendosja e një deklaratë kalimtare
  - D. Asnjë nga të mësipërmet
2. Jeta, një ekzaminuese e certifikuar i mashtrimit, mori në interviste Yllin, kontrollues i kompanisë ABC. Jeta e pyeti si me poshte: "Duke qenë se ishit këtu kur u zhvilluan kontrollet, a mund të më thoni se si u bë kjo?" Kjo lloj pyetje quhet një \_\_\_\_\_.
  - A. Pyetje negative
  - B. Teknika e përgjigjes së kontrolluar**
  - C. Pyetje komplekse
  - D. Asnjëra sa më lart
3. Fitore është Drejtore Ekzekutiv i SkyFox Group, një firmë keshilluese. Shitjet janë rritur së paku shtatë për qind çdo vit gjatë pesë viteve të fundit. Fatkeqësisht, kompania ka hasur në një rënie këtë vit, dhe të hyrat janë shumë më pak se të parashikuarat.

Megjithatë, në mënyrë që ta marr bonusin e tij për performancë, Fitore duhet të tregoj një rritje në shitje së paku 7.5 për qind. Kur të paraqiten pasqyrat financiare, shitjet janë rritur për saktësisht 7.5 për qind.

Cila nga këto analiza të koeficienteve do të ishte më e dobishme në zbulimin se Jehona i ka përfshirë shitjet fiktive në financat e kompanisë?

- A. Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme**
- B. Qarkullimi i inventarit
- C. Koeficienti i shpejtë
- D. Koeficienti i borxhit

4. Lulzim është menaxher i Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe po përzgjedh një numër punëtorësh të rinj. Ai është i vetëdijshëm për problemet e mashtrimit potencial, pasi që kompania ka pasur probleme me punëtorët e vet me heret. Për këtë arsye ai merr disa hapa në lidhje me mbledhjen e informacionit.

Percaktoni cilat informacione janë të duhura për t'u mbledhur në vlerësimin e mashtrimit potencial:

- A. Bashkëshorti/ja e punëtorit potencial ka humbur vendin e punës.
- B. Punëtori/ja potencial ka problem me drogën, alkolin apo bixhozin.
- C. Punëtori/ja potenciale ka blerë shtëpi, me hipotekë me normë rritëse e të ndryshueshme.

**D. Të gjitha si më lart**

5. Artoni e ka njohurinë e duhur mbi kontrollet e brendshme dhe di që ato janë të rëndësishme. Kompania është përmiresuar, por ende ka probleme në fusha të caktuara. Nga vlerësimi i rrezikut, ai merr këto rezultate:

- I. Monitorim i paefektshëm i menaxhmentit të lartë
- III. Ndarje e duhur e detyrave
- IV. Kontrolle të forta të brendshme
- IV. Menaxhmenti i mesëm është indiferent

Cilat janë fushat ku duhet të fokusohet Faton me qëllim zvogëlimin e mundësisë për mashtrim:

- A. I, II dhe III
- B. I dhe II
- C. I dhe IV**
- D. II dhe IV

6. Butrinti bleu një makinë të përdorur nga Arjan, i cili siguroi Butrintin se makina do të punonte për shumë kohe. Një javë pasi Butrinti bleu makinën, motori u prish. Në cilat prej rrethanave të mëposhtme një gjykatë me siguri do të gjente se Arjani kishte bërë një interpretim mashtrues?

**A. Arjani e dinte se makina kishte dëme të konsiderueshme në motor dhe do të prishej brenda pak ditësh, por nuk i tha Butrintit**

- B. Arjani nuk mendonte se makina do të zgjaste shumë, por ai nuk i tha Butrintit
- C. Arjani e dinte se makina ishte shumë e vjetër, por ai nuk i tregoi Butrintit
- D. Arjani nuk do të zbulohej se kishte bërë një keqinterpretim mashtrues në ndonjë nga rrethanat e mësipërme

7. Burim, një hetues i mashtrimit, po e zhvillon një intervistë me Ilirin. Ndonëse Iliri i dëgjoji të gjitha pyetjet gjatë pjesë hyrëse të intervistës, ai filloi ta pyes Burimin që t'i përsërit pothuajse çdo pyetje kur ata u fokusuan më shumë. Cilat nga zgjedhjet më poshtë është shkaku më i mundshëm i sjelljes së Valonit?

- A. Iliri po e teston aftësinë e Burimit për të parashtruar pyetje konsistente
- B. Iliri e humb dëgjimin gjatë situatave stresuese
- C. Iliri po e vonon përgjigjen ashtu që ai ka më shumë kohë të mendojë se çfarë të thotë**
- D. Asnjëra nga më lartë

8. Jehona, një ekzaminuese e certifikuar e mashtrimit, po kryen një intervistë që synon pranimin nga Valon, një i dyshuar për mashtrim. Jehona e pyet Valonin: "A keni nevojë vetëm për para shtesë, apo a keni bërë këtë sepse keni pasur probleme financiare?" Kjo quhet një:

**A. Pyetje alternative**

- B. Pyetja e racionalizimit
- C. Pyetje e Standardit
- D. Asnjëra sa më lart

9. Nita është kontabilisti i një kompanie me aktivitet dhenie te pajisjeve me qera. Pas regjistrimit të shitjet në cash dhe përgatitjen e depozitës bankare, ajo merr 150 EUR nga totali. A është ky një shembull i një skeme mashtrimi?

A. E vërtetë

**B. E gabuar**

10. Gramoz është meanxher në një kompani që prodhon lëngje frutash në jug të Kosovës. Ai është shumë punëtor dhe merr rrallë pushime. Në praktiken e kompanisë, paratë mbledhen nga Gramoz i cili i merr ose nga shoferët që sjellin paratë dhe ceqet që mbledhin nga klientët e tyre gjatë rrugës, ose nga klientët të cilët postojnë pagesat nëpërmjet zarfit direkt në zyrë.

Gramoz vodhi paratë nga depozitat e mbledhura te shofereve te rrugës dhe e mbuloi duke përdorur disa prej pagesave që vinin nëpërmjet zarfit në zyrë. Cili nga flamujt e kuq vijues të pranishëm që mund të kishin alarmund të alarmojnë kompaninë për mashtrimin?

A. Ankesat e klienteve

**B. Depozitë e humbur**

- C. Gramoz nuk merrte asnjehere pushim
- D. Të gjitha të mësipërme

11. Kur ndodh mashtrimi i menaxhimit, kompanitë zakonisht:

A. Mbivlerësojnë pasuritë dhe nënvlerësojnë të ardhurat neto.

B. Nënvlerësojnë pasuritë dhe të ardhurat neto.

**C. Mbivlerësojnë pasuritë dhe të ardhurat neto.**

D. Nënvlerësojnë pasuritë dhe mbivlerësojnë të ardhurat neto.

12. Nga llogaria bankare e ABC. Co., mungojnë fondet. Hetuesi i mashtrimit i caktuar për rastin fillon të mendojë: "Kush ka pas mundësinë dhe motivin që t'i shtijë në dorë këto të holla?" Mbase pa dashje, hetuesi i mashtrimit po e performon analizën \_\_\_\_\_ .

A. Kategorike

B. Empirike

C. Teoricien

**D. Bihavioriste**

13. Cila prej metodave vijuese të parandalimit të mashtrimit është përgjithësisht më efektive?

**A. Rritja e perceptimit të zbulimit**

B. Deklaratat e menaxherëve që dënojnë mashtrimin

C. Sisteme efektive te kontrollit te brendshem

D. Minimizimi i presioneve mbi punëtorët

14. Kur kemi të bëjmë me dokumente dhe forma të tjera të provave të prekshme, është e domosdoshme të ruhet \_\_\_\_\_ e sendit për të vërtetuar vërtetësinë e tij dhe për të siguruar që nuk është ndryshuar apo modifikuar që nga momenti i mbledhjes.
- A. Vula e provës
  - B. Vlera provuese
  - C. Zinxhiri i kujdestarisë**
  - D. Asnjëra sa më lart
15. Cili element ne Diamantin e Mashtrimit thekson që edhe karakteristikat e individëve janë të rëndësishme
- A. Presioni i perceptuar
  - B. Mundësia e perceptuar
  - C. Racionalizimi
  - D. Kapaciteti**
16. Cila prej më poshtë mund të konsiderohet si anomali analitike:
- A. Ndryshim i amortizimeve mbi bazen e politikës së aprovuar nga Bordi të aseteve të kompanisë
  - B. Blerje të tepërta**
  - C. Mungesat apo korrigjimet në inventar të dokumentuara nga punonjësit përkatës
  - D. Memorandume të debisë apo kredisë të shoqëruara me shpjegimet përkatëse
17. Në situatat e intervistimit, procesi i vëzhgimit të sjelljes para se të parashtrahet pyetja kritike quhet:
- A. Vlerësimi
  - B. Normimi ose kalibrimi**
  - C. Analiza e mashtrimit
  - D. Asnjëra sa më lart
18. Arsye që punonjësit kryejnë mashtrime të deklaratave financiare përfshijnë cilat nga këto?
- A. Të demonstrojnë fitime në rritje për aksion, duke inkurajuar kështu rritjen e pagesave të dividendëve
  - B. Për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e kompanisë
  - C. Për të marrë financime të reja ose për të marrë kushte më të favorshme për financimin ekzistues
  - D. Të gjitha sa më sipër**
19. Cila prej sa më poshtë mund të MOS konsiderohet simptom i mashtrimit:
- A. Anomalitë në kontabilitet
  - B. Anomalitë analitike
  - C. Stili i jetesës**
  - D. Raportimet dhe ankesat

20. Të gjitha kushtet e mëposhtme janë të favorshme për raportim financiar mashtrues PËRVEÇ:
- A. Transaksione relativisht të vogla ose balancat që janë lehtësisht të auditueshme**
  - B. Dominimi i menaxhimit nga një person i vetëm ose një grup i vogël
  - C. Transaksione të rëndësishme dhe të pazakonta me palët e lidhura
  - D. Përdorimi i politikave kontabël tepër agresive në bazë të materialitetit
21. Dobësite e kontrollit të brendshëm paraqiten në cilën si më poshtë:
- A. Ekzistenca e masave mbrojtëse fizike
  - B. Ndarja e detyrave mes punonjesve
  - C. Sistem joadekuat kontabël**
  - D. Forcimi i kontrolleve ekzistuese
22. Cili është synimi i një vlerësimi të rrezikshmërisë së mashtrimit?
- A. Të vlerësojë dizajnin dhe efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të organizatës kundrejt raportimit financiar
  - B. Të ndihmojë organizatën të identifikojë se ku është më e cenueshme ndaj mashtrimit**
  - C. Të nxjerrë një vlerësim të përafërt të humbjeve të organizatës nga mashtrimi
  - D. Të përcaktojë fajësinë apo pafajësinë e punëtorit të dyshuar për mashtrim
23. Tregues të dobisë së Vlerësimit të rrezikshmërisë së mashtrimit (e VRM-së) janë:
- A. Projektimi i teknikave për hetim të mashtrimit
  - B. Identifikimi ku është cenueshmëria, si dhe aktivitetet që e rrisin rrezikun
  - C. Hartimi i planeve strategjike dhe taktike për zbutje të rreziqeve
  - D. Të gjitha sa më sipër**
24. Cila nga këto në vijim zakonisht konsiderohet si burimi më i dobishëm i informacionit financiar në dispozicion për hetuesit e mashtrimit për gjurmimin e qëllimeve?
- A. Deklarimi i taksave
  - B. Pasqyrat financiare
  - C. Të dhënat bankare**
  - D. Asnjëra nga më lartë
25. Cila nga këto në vijim është shembull i një metode indirekte e lokalizimit të pasurive apo gjurmimit të fondeve të paligjshme?
- A. Analiza e vlerës neto**
  - B. Analiza e korrelacionit
  - C. Metoda e zërave të veçantë
  - D. Të gjitha nga më lartë
26. Cila nga të mëposhtmet është një shembull i konfliktit të interesit?
- A. Një punonjës i cili ka një interes të fshehtë në një transaksion; por punonjësi nuk vepron në një mënyrë të dëmshme për kompaninë e tij
  - B. Një punonjës i cili ka një interes të zbuluar ekonomik apo personal në një transaksion që nuk ndikon negativisht punëdhënësin e tij
  - C. Një punonjës që blen furnizime nga kompania e bashkëshortes**
  - D. Punësim pas 10 vitesh me ish-kontraktorin

27. Cilat nga këto ne vijim përfaqësojnë njëri nga shtyllat e trekëndëshit të mashtrimit?
- A. Burimet financiare të menjëhershme
  - B. Pranimi i heshtur i perceptuar
  - C. Racionalizimi**
  - D. Asnjëra nga më lartë
28. Cila nga procedurat e mëposhtme NUK do të ishte e dobishme në parandalimin dhe zbulimin skemave mashtruese ne shitje:
- A. Rritja e masave të sigurisë fizike në dalje të punonjësve
  - B. Përgatitja e përmbledhjes së shitjeve neto për secilin punonjësi dhe identifikimi punonjësve me shitjet me të ulëta
  - C. Krahasimi i regjistrimit të parase se gatshme me gjendjen fizike dhe kontrolli për mospërputhje**
  - D. Ofrimi i zbritjeve për klientët të cilët nuk marrin faturat për blerjet e tyre
29. Cila prej me poshte klasifikohet si rrezik mashtrimi në raportimin financiar:
- A. Përvetësimi i fshehtë i aseteve**
  - B. Ndihma apo nxitja e mashtrimit nga palë të jashtme (konsumatorë, furnitorë)
  - C. Pagesa apo favore për kompani
  - D. Asnjëra nga më lartë
30. Cilat raporte do të konsideronit flamuj të kuq:
- A. ↑ Inventari me ↑ Të pagueshmet
  - B. ↓ Të Ardhurat me ↓ Të arkëtueshmet
  - C. ↓ Të ardhurat me ↓ Elemente të rrjedha së keshit
  - D. ↑ Të Ardhurat me ↓ Inventari**
31. Cila prej me poshte klasifikohet si rrezik mashtrimi në korrupsion:
- A. Përvetësimi i fshehtë i aseteve
  - B. Shuma të pasqyruara gabimisht në bilanc të gjendjes, duke përfshirë rezervat
  - C. Konflikti i interesave dhe manipulimi me informata të brendshme
  - D. Pagesa apo favore për zyrtarë publikë**
32. “Përmirësimi i komunikimit dhe vetëdijes për mashtrimin”, si një prej dobive të Vlerësimi i rrezikshmërisë së mashtrimit duhet të nenkuptohet si:
- A. Përafrimi mes palëve të përfshira dhe orientimi i veprimeve
  - B. Menyre që ndihmon në të fokusuarit tek rreziqet e mëdha
  - C. Teknike që mund të ulë racionalizimin e mashtruesit të mundshëm**
  - D. Pengese ndaj mashtruesit potencialë, duke përforcuar perceptimin e zbulimit

33. Cila prej këtyre NUK është e saktë në lidhje me procesin e përcaktimit të objektivit të programit të menaxhimit të rrezikshmërisë së mashtrimit?
- A. Menaxhmenti duhet të baraspeshojë investimin në kontrollet kundër mashtrimit me dobinë e atyre kontrolleve, si dhe sasinë e rreziqeve që ka vullnet të pranojë.
  - B. Menaxhmenti duhet të shikojë rastet e mëparshme të mashtrimit për të përcaktuar se si do të mund të parandaloheshin ato me një program ideal të menaxhimit të rrezikshmërisë së mashtrimit.**
  - C. Objektivat e hollësishëm të programit të menaxhimit të rrezikshmërisë së mashtrimit duhet të përshtaten me nevojat dhe qëllimet specifike të organizatës.
  - D. Menaxhmenti duhet t'ia caktojë një masë kuantitative apetitit të tij për rrezikshmëri, ashtu që të mund të masë efektshmërinë e programit të menaxhimit të rrezikshmërisë së mashtrimit.
34. Cila nga këto është e vërtetë në lidhje me shkallën e mashtrimit të përshkruar në tekstin si vijon:
- A. Kur rritet presioni financiar, edhe mundësia e perceptuar e ulët është e mjaftueshme për të kryer mashtrime.
  - B. Sa më e ulët të jetë mundësia e perceptuar për të kryer mashtrime, aq më shumë racionalizim ka për të kryer mashtrime.
  - C. Sa më i ndershëm është një person, aq më i ulët është nevoja për të racionalizuar veprimin e mashtrimit.**
  - D. Ndërsa 'nevoja' për të rritur lojrat e fatit, racionalizimi për të kryer mashtrime bëhet më i lehtë.
35. Cila prej renditjeve të mëposhtme është e duhura në kornizën COSO:
- A. Identifikimi i ngjarjeve, Vlerësimi i rrezikshmërisë, Aktivitetet e kontrollit**
  - B. Vlerësimi i rrezikshmërisë, Reagimi ndaj rreziqeve, Informimi dhe komunikimi
  - C. Mjedisi i brendshëm, Identifikimi i ngjarjeve, Vlerësimi i rrezikshmërisë
  - D. Identifikimi i ngjarjeve, Mjedisi i brendshëm, Reagimi ndaj rreziqeve
36. Auditorët e brendshëm mund të jenë përgjegjës për:
- A. Drejtimit dhe kontrollit të aktiviteteve ditore
  - B. Permiresimin e efektshmërisë së proceseve të menaxhimit, kontrollit të rreziqeve dhe qeverisjes në organizatë.
  - C. Hetimin e dyshimeve për mashtrim**
  - D. Asnjëra nga më lartë
37. Cilat nga këto në vijim NUK konsiderohen si pjesë e politikës proaktive të mashtrimit?
- A. Vendet vakante mandatore të zbatuara me forcë
  - B. Auditimet e befasishme
  - C. Shfrytëzimi i paketit të rishikimit analitik**
  - D. Marrja në pyetje për vlerësimin e mashtrimit

38. Cila nga këto NUK do të konsiderohet si një konflikt interesi?
- A. Një punonjës i cili ka një interes të pazbuluar ekonomik në një transaksion që ndikon negativisht punëdhënësin e tij
  - B. Një punonjës i cili ka një interes të pazbuluar në një transaksion dhe që vepron në mënyrë të dëmshme për kompaninë e tij në mënyrë që të përfitojë një i afërm, por jo vete punonjesi.
  - C. Një punonjës i cili ka një interes personal të zbuluar, por që nuk është ekonomike. Interesi i tij është në një transaksion që nuk ndikon negativisht punëdhënësin e tij.**
  - D. Të gjitha më lart
39. Sipas “Shkallës së mashtrimit,” mashtrimi profesional mund të ndodh më shumë kur:
- A. Integriteti personal është i ulët
  - B. Mundësitë e pranuar janë të larta
  - C. Presionet e situatës janë të larta
  - D. Të gjitha nga më lartë**
40. Ndërsa një objektiv i ekzaminuesit të mashtrimit është të përcaktojë nëse ka ndodhur mashtrimi dhe kush ka mundësi të jetë përgjegjës, qëllimi i ekzaminuesit të forenzikës financiare është:
- A. Të përcaktojë nëse pretendimet janë të arsyeshme në bazë të provave financiare dhe nëse po, ndikimin financiar të akuzave.**
  - B. Te mbledhe provat e nevojshme financiare dhe jofinanciare për të shqyrtuar në mënyrë të pavarur akuzat dhe për të përcaktuar ndikimin e tyre financiar.
  - C. Te llogarit ndikimin financiar në bazë të supozimeve;
  - D. Te përpiqet të mbledhë dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur ose hedhur poshtë pretendimet dhe dëmet që lidhen me to.
41. Cila nga këto nuk është një simptomë e një prej gjashtë kategorive të zakonshme të mashtrimit?
- a. Kur të dhënat jofinanciare lidhen me të dhënat financiare**
  - b. Anomali të e pashpjegueshme të kontabilitetit.
  - c. Dobësitë e kontrolluara të brendshme të shfrytëzuara.
  - d. Anomali të komunikohen nëpërmjet këshillave dhe ankesave.
42. Metodat që kompanitë përdorin për të fshehur pagesat e rryshfeteve dhe / ose rryshfetet për të mundësuar mbi/nen faturime përfshijnë të gjitha të mëposhtme përveç:
- A. të punësuar fantazmë
  - B. skema pagesa të mbifaturuara (skemat overbilling)
  - C. zvogelimin e stokut**
  - D. të pagueshmet fiktive

43. Standardi ndërkombëtar i Auditimit (ISA) 240, Përgjegjësia e Auditorit merr parasysh mashtrimin brenda auditimit të pasqyrave financiare sipas elementit:
- A. Siguria absolute që pasqyra financiare nuk ka keqparaqitje materiale
  - B. Rreziku i keqparaqitjes materiale për shkak të mashtrimit, duke përfshirë mashtrimin nga menaxhmenti**
  - C. Reagimi pasiv ndaj mashtrimit të identifikuar apo të dyshuar
  - D. Të gjitha nga më lartë
44. Përgjithësisht, mashtrimi është i mundshëm nëse të tre elementet janë të pranishme me bollëk, por mashtrimi mund të mos ndodhë kur presioni është i ulet, dhe mundësia e ulet.
- A. E vërtetë**
  - B. E gabuar
45. Parandalimi i mashtrimit fillon:
- A. Me kontrollet e brendshme të punëdhënësit.
  - B. Me ekzaminimin e mashtrimit.
  - C. Në mendjen e punonjësit.**
  - D. Me veprime rregullatore dhe ligjore
46. Dëshmia relevante është dëshmi e cila ka të bëjë me një rast që tenton të vërtetojë ose hedh poshtë një fakt dhe gjithmonë pranohet në këtë rast
- A. E vërtetë
  - B. E gabuar**
47. Cila nga këto është modeli i saktë i kontabilitetit?
- A. Asetet + Detyrimet = Kapitali I Pronarëve
  - B. Asetet = Detyrimet - kapitalin e pronarëve
  - C. Asetet = Detyrimet + kapitali pronarëve**
  - D. Asnjë nga më lartë
48. Mashtrimi në pasqyrat financiare zakonisht merr formën e ekzagjerimit:
- I. aktiveve ose të ardhurave
  - II. detyrimet dhe shpenzime
- A. I vetëm
  - B. Të dy I dhe II**
  - C. II vetëm
  - D. As I e as II

49. Metoda e vlerës neto është efektive:

- A. Për të mbajtur intervistat e të dyshuarve.
- B. Si provë në gjykatë.
- C. Për të nxjerrë rrëfimin e fajit.

**D. Të gjitha si më lart.**

50. Në shumicën e rasteve të intervistës, disa pengesa sociale-psikologjike do të pengojnë komunikimin ndërmjet intervistuesit dhe të intervistuarit. Një pengesë e tillë është \_\_\_\_\_, që i referohet tendencës së të anketuarit për të ngatërruar rendin e përvojave.

**A. Hutimi kronologjik**

- B. Konfuzioni i pavetëdijshtëm
- C. Konfuzioni i drejtpërdrejtë
- D. Asnjë nga të mësipërme